

**VENDIM**  
**Nr. 334, datë 4.5.2016**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR  
MINISTRINË E ZHVILLIMIT URBAN, PËR KRYERJEN E KONKURSIT  
RAJONAL PËR ZHVILLIMIN HAPËSINOR TË ZONAVE “SHTIGJET E LIRISË”  
DHE “KORRIDORI I GJELBËR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Zhvillimit Urban, në buxhetin e vitit 2016, i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh për kryerjen e konkursit rajonal për zhvillimin hapësinor të zonave “Shtigjet e lirisë”, që shtrihet në territorin e rajoneve Gjakovë-Tropojë-Has, dhe “Korridori i gjelbër”, që shtrihet ndërmjet territorit të rajoneve Prizren-Kukës.

2. Fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh të përdoret për mbulimin e çmimeve fituese të konkursit dhe, përkatësisht, për:

- 2 (dy) çmime të para – 900 000 (nëntëqind mijë) lekë secili;
- 2 (dy) çmime të dyta – 450 000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë secili;
- 2 (dy) çmime të treta – 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë secili.

3. Fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2016.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Urban për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**